

Skenderbeu/ Ne Korce kerkojne lirimin e tifoze nga burgu

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 28 Shtator 2013 15:26



Nje tifoz i Skenderbeut eshte ne nje nga burgjet e Tiranes. Nje djalosh 18 vjecar eshte arrestuar dhe izoluar ne burg per shkak te nje doreze hekuri te gjetur ne xhepin e tij ne ndeshjen e nje jave me pare Tirana-Skenderbeu. Tifozet e Skenderbeut bejne apel per te pare edhe nje here te lire shokun e tyre. Ne qytetin e Korces te gjithe jane te alarmuar nga ky lajm i hidhur dhe presin nje zgjidhje te shpejte per djalin e arrestuar.